

INFORMACION MBI ZHVILLIMIN E KONFERENCËS SË DHJETË NDËRKOMBËTARE TË DEPARTAMENTIT TË GJUHËS ANGLEZE

Në datat 12 dhe 13 maj 2017 Departamenti i Gjuhës Angleze organizoi Konferencën e 10-të ndërkombëtare me temë "New Dimensions and Approaches in English Studies", në të cilën u mbajtën 58 kumtesa në fushën e gjuhësisë, mësimdhënies dhe metodologjisë së gjuhëve të huaja, studimeve përkthimore, letërsisë, studimeve kulturore dhe komunikimit, të përgatitura nga 78 studiues dhe pedagogë të universiteteve shqiptare dhe të huaja.

Të ftuarve të pranishëm ju uroi mirëseardhjen Përgjegjësi i Departamentit të Anglishtes, Prof. Dr. Viktor Ristani, i cili vuri në dukje rëndësinë e kësaj konference jubilarë, duke theksuar, ndër të tjera, ndihmesën dhe mbështetjen e Rektoratit të UT-së, Dekanatit të FGJH-së, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara dhe Këshillit Britanik për Departamentin e Gjuhës Angleze.

Në seancën plenare ishin të pranishëm Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Mynyr Koni, Dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja Prof. Dr. Artur Sula, Zj. Meghan McGill, zëvendës shefe e Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Ambasadën Amerikane, Zj. Aida Berxholi, Drejtoreshë e Këshillit Britanik (pranë Ambasadës Britanike në Tiranë), të cilët në fjalën e tyre përshëndetëse, duke falenderuar organizatorët e kësaj konference, pararendëse e veprimtarive të parashikuara në kuadrin e 60-vjetorit të themelimit të Universitetit të Tiranës, theksuan rëndësinë e saj, jo vetëm për Departamentin e Anglishtes, por edhe Fakultetin e Gjuhëve të Huaja. Gjithashtu, në këtë kontekst, u vlerësuan përpjekjet e vazhdueshme në përmbushjen e synimeve për një proces mësimdhënie dhe edukimi sa më të mirë të studentëve në përballimin e sfidave në të ardhmen. Bashkëpunimet e mëparëshme, si dhe bashkëpunimet e mundëshme në të ardhmen, u vlerësuan si ndihmesë në sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë së duhur të përgatitjes së studentëve në përputhje me kërkesat e tregut kombëtar, rajonal e ndërkombëtar të punës.

Në këtë konferencë ishin të ftuar si referues kryesorë në seancën plenare profesorët dhe kërkuesit e mirënjohur Prof. Dr. Xhevat Lloshi me kumtesën "Përkthimet shqip nga anglishtja - vështrime të reja", Prof. Dr. Refik Kadija me kumtesën, "Bibliographical notes on the development of the Scanderbeg theme in the English language", si edhe profesori amerikan William K. Martin, PhD me kumtesën "Some Thoughts on Critical Thinking".

Pjesëmarrësit vazhduan më tej me referimet e temave të përgatitura dhe diskutimet në seanca të njëkohësishme sipas fushave studimore dhe kërkimore-shkencore të veçanta, të shoqëruar nga pyetje, diskutime dhe sugjerime për të ardhmen e kërkimit shkencor në këtë fushë. Konferenca dhe kumtesat e natyrave dhe fushave të ndryshme të studimeve të gjuhës angleze i shërbyen studiuesve, veçanërisht kërkuesve të rinj dhe studentëve të Programeve Master i Shkencave në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, të cilët ndoqën me interes disa prej këtyre seancave, mësimdhënësve të gjuhës angleze, si dhe grupeve të ndryshme të interesit në institucionet e arsimit të lartë në shkëmbimin e përvojave të tyre, forcimit dhe thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit profesional dhe ndër-institucional, si edhe zgjerimit të rrjetit të bashkëpunimit profesional e ndërpersonal në këtë fushë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE





